EMRAT/ Iu sekuestrohet drogë dhe arsenal municionesh, pranga çiftit të bashkëshortëve dhe djalit të tyre

26 Shtator, 2022 12:28



Madhësia e tekstit:

Vijojnë goditjet e njëpasnjëshme ndaj veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve dhe të armëmbajtjes pa leje, ndërsa më pranga janë vënë një çift bashkëshortes dhe djali i tyre.

Bëhet fjalë për shtetasit Ilir, Marjana dhe Dejvi Çoniku.

NJOFTIMI I POLICISE

Finalizohet operacioni policor i koduar "Relatives", nga Seksioni kundër Narkotikëve, në bashkëpunim me Seksionin Operacional dhe Forcën e Posaçme "Shqiponja", në DVP Elbasan.

Ushtronin veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve, vihen në pranga një çift bashkëshortësh dhe djali i tyre.

Sekuestrohen 5 kg kanabis dhe një sasi municioni luftarak.

Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve dhe të armëmbajtjes pa leje, si rezultat i kontrolleve të shtuara dhe informacioneve të marra në rrugë operative, nga Seksioni kundër Narkotikëve, në bashkëpunim me Seksionin Operacional dhe Forcën e Posaçme "Shqiponja", në DVP Elbasan, u organizua dhe u finalizua me sukses operacioni policor i koduar "Relatives", si rezultat i të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

I. Ç., 46 vjeç, M. Ç., 41 vjeçe (bashkëshortë) dhe shtetasi D. Ç., 23 vjeç (djali i tyre).

Nga veprimet hetimore dyshohet se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, ushtronin veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve.

Gjatë kontrollit në dy banesa në përdorim nga kjo familje, në Gramsh, janë gjetur dhe sekuestruar 5 kg lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa, që dyshohet se janë prodhuar dhe përgatitur për shitje nga 23-vjeçari dhe prindërit e tij.

Gjithashtu, gjatë kontrollit të dy banesave u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale edhe një sasi municioni luftarak.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprime të mëtejshme procedurale.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arrestim | Drogë | Familja

TË NGJASHME



Arrestimi i mjekut të spitalit të Traumës, reagon PD: Show i Ramës për të mbuluar skandalin e mbylljes së shkollës "Mehmet Akif", duan...

25 Shtator, 2022



Tentoi të kalonte 5 emigrantë të paligjshëm në kufirin e Morinës, arrestohet 44-vjeçari, policia i sekuestron edhe një shumë parash

25 Shtator, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Abuzuan me tenderin me vlerë 10.5 mln lekë, lihen në burg 4 punonjësit e Universitetit Bujqësor

26 Shtator, 2022



Vrau vëllain dhe kunatën/ Apeli të në burg Arsen Muskurtin, avokati kërkon ekspertim të shëndetit mendor

26 Shtator, 2022



VIDEO/ Nga trafikimi i të miturave në Rumani, te akuzat për zhdukjen e "Renit të Elbasanit"! E kërkonte gjithë Evropa, si u kap "Gucci" nga Durrësi në Kolumbi (DETAJE)

26 Shtator, 2022



Probleme me pasurinë, shkarkohet nga detyra gjyqtarja e Gjirokastrës, Blerta Marku

26 Shtator, 2022



Greqi/ Foshnja 4 muajshe me dëmtime në tru dhe në rrezik për jetën, pas babait arrestohet dhe nëna, çifti nga Shqipëria akuzohen për tentativë vrasje (DETAJE)

26 Shtator, 2022



"Luani i Artë"/ Zhulohet trafikanti që dërgon emigrantët shqiptarë me gomone në Britani, Daily Mail: Fiton 1 mln paund në javë nga tregtia me njerëzimin (Video)

26 Shtator, 2022

KATEGORIA VIDEO



Heqja e licencës për kolegjin Mehmet Akif, Berisha: Vendimi u mor jashtë Shqipërisë, Erdogan urdhëron mbyllje shkollash e xhamish

26 Shtator, 2022



Betohet para Presidentit të Republikës, gjyqtari më i ri i Gjykatës Kushtetuese Ilir Toska

26 Shtator, 2022



"Tërhiquni nga vendimi dhe hapni shkollën", nxënëset e "Mehmet Akif" protestë për 60 minuta para Kryeministrisë, dorëzojnë peticionin me mbi 10 mijë firma

26 Shtator, 2022



Mbyltja e kolegjit "Mehmet Akif"/ "Merruni me pronarët", protestuesët në mes të shut i kthehen Ramës: Dilni nga zyra dhe na jepni përgjigje!

26 Shtator, 2022



"Vëllezërit e Italisë" festuan me muzikën e Rino Gaetanos, Meloni në lot nga gëzimi, çfarë ndodhi pas mbylljes së votimeve (VIDEO)

26 Shtator, 2022



Protestë poshtë zyrës së Ramës/ "Anuloi", nxënëset e "Mehmet Akif" bëjnë veprimin simbolik kundër vendimit të qeverisë për mbylljen e shkollës (VIDEO)

26 Shtator, 2022

Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT



Organizata për Zhvillim Ekonomik: Lufta në Ukrainë me ndikim më të madh në ekonominë botërore

26 Shtator, 2022



Francë, avioni del nga pista dhe rrëzohet në ujë, shpëtojnë mrekullisht 3 personat në bord

26 Shtator, 2022



Dështim i madh, shifrat nuk gënjejnë, 1 pikë në 3 ndeshje i rrinë ngushtë Shqipërisë

26 Shtator, 2022



Lajm i mirë për Kosovën, liberalizimi i vizave në rendin e ditës në BE më 13 tetor

26 Shtator, 2022



Kërcënimi për përdorimin e armëve bërthamore nga Putin, Zelensky: Nuk mendoj se ai po bën bluf

26 Shtator, 2022



Sulm i gjerë kibernetik ndaj përdoruesve të telefonisë celulare në Australi

26 Shtator, 2022

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2022 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.